VENDIM
Nr. 119, datë 17.7.2020

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "ALBGAZ" SHA, PËR ZGJATJEN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE, PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E OPERIMIT TË HAPËSIRAVE TË DEPOZITIMIT TË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 16, pika 12; neneve 46 dhe 56, të ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror"; nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë", si dhe nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.7.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 86/1 prot., datë 8.7.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, lidhur me kërkesën e shoqërisë "Albgaz" sh.a. "Për shtyrjen e afatit të vendimmarrjes për licencimin e shoqërisë në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 190, datë 25.11.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë "Albgaz" sh.a., në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje, ERE, me shkresën nr. 32/55 prot., datë 25.11.2019, ka kryer njoftimin në median e shkruar, si dhe me shkresën nr. 729/1 prot., datë 3.12.2019, ka përcjellë pranë subjektit "Albgaz" sh.a. njoftimin e vendimit të fillimit të procedurës, si dhe mungesën e dokumentacionit të konstatuar.
- Me shkresat nr. 84 prot., datë 16.1.2019 dhe nr. 288/1 prot., datë 4.2.2020, ERE i është drejtuar shoqërisë me një kujtesë për plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- Shoqëria "Albgaz" sh.a., me shkresën nr. 288/2 prot., datë 8.2.2020, ka përcjellë në ERE kërkesën për shtyrje të vendimmarrjes së Bordit, në pamundësi për t'i plotësuar këto dokumente brenda afateve dhe ka deklaruar se një pjesë e tyre është në proces përpilimi.
- Bordit i ERE-s, me vendimin nr. 43, datë 6.3.2020, vendosi të pranojë kërkesën e shoqërisë për shtyrjen e vendimmarrjes për licencimin e shoqërisë, deri në datën 1.7.2020.
- Së fundmi (përpara përfundimit të këtij afati), shoqëria Albgaz sh.a., me shkresën nr. 122/1 prot., datë 29.6.2020, protokolluar në ERE me nr. 288/4, datë 29.6.2020, ka paraqitur sërish në ERE kërkesë për shtyrjen e vendimmarrjes së Bordit mbi këtë licencim deri në datën 10.10.2020, duke argumentuar se për shkak të mbylljes së çdo shërbimi që erdhi si rezultat i pandemisë COVID -19, nuk ka pasur mundësi të plotësojë dokumentacionin e munguar dhe kërkon miratimin e ERE-s për të shtyrë këtë vendimmarrje.
- Duke qenë se kërkesa e shoqërisë për shtyrje të afatit të vendimit të Bordit, është depozituar përpara përfundimit të afatit të vendosur në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 43, datë 6.3.2020 dhe duke marrë parasysh të gjitha kufizimet e vendosura gjatë kësaj periudhe me qëllim parandalimin e përhapjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, kërkesa e shoqërisë është e arsyeshme dhe e bazuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë "Albgaz" sh.a. për zgjatjen e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë për licencimin në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror deri në datën 10.10.2020.

2. Shoqëria Albgaz sh.a. të marrë masa për të depozituar në ERE dokumentacionin e munguar, jo më vonë se data 1.10.2020.

3. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti